

Në bazë të nenit 5 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social të cilët janë të goditur nga kriza energjetike dhe financiare, me nr. 08-5586/1 të datës 29.05.2023, dhe në lidhje me Vendimin për përcaktimin e shumës maksimale për ndarjen e ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social, të cilët janë të goditur nga kriza energjetike dhe financiare, banorë të qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 08/23), Qyteti i Shkupit shpall:

**THIRRJE PUBLIKE  
PËR NDARJEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PERSONAT E RREZIKUAR PËR  
NGA ASPEKTI SOCIAL TË CILËT JANË TË GODITUR NGA KRIZA  
ENERGJETIKE DHE FINANCIARE PËR VITIN 2023**

**1. LËNDA E THIRRJES PUBLIKE**

1.1. Lënda e thirrjes publike është ndarja e ndihmës financiare për qytetarët – banorë të qytetit të Shkupit, të cilët i përkasin kategorive të rrezikuara sociale dhe të cilët janë të goditur nga kriza energjetike dhe financiare, përmes pagesës së mjeteve në llogaritë e tyre të transaksionit.

1.2. Mjetet të cilat i ndan Qyteti i Shkupit si mjete financiare janë në shumën prej 3000 denarë për person (ndihmë e njëfishtë) me llogaritjen e tatimit të fitimit personal.

1.3. Mjetet nga pika 1.2. janë të siguruara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2023, në shumë të përgjithshme prej 15.000.000 denarë.

1.4. Thirrja publike do të zgjasë deri më 09.08.2023 ose deri në përfundimin e mjeteve të parapara financiare në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, në varësi prej faktit se cili kusht do të shfaqet i pari.

1.5. Kërkesat e dorëzuara në Arkivin e Qytetit të Shkupit do të evidentohen në kohën e saktë të parashtrimit (data, ora dhe minuta) dhe të njëjtit do të shqyrtohen sipas radhitjes së datës dhe kohës së dorëzimit.

**2. E DREJTA E PJESËMARRJES NË THIRRJEN PUBLIKE**

Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë qytetarët të cilët i përkasin kategorive të rrezikuara për nga aspekti social – banorë të qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare), të cilët i përmbushin kushtet e kësaj thirrjeje publike, deri në përfundimin e mjeteve buxhetore të përcaktuara për thirrjen publike, por jo më vonë se 09.08.2023.

### 3. KUSHTET E PJESËMARRJES NË THIRRJEN PUBLIKE

Parashtruesi duhet ti plotësoj këto kushte vijuese:

- Të jetë banorë i qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare);
- Parashtruesi duhet ti përket kategorisë së rrezikuar për nga aspekti social, me sa vijon:
  - të jetë shfrytëzues i ndihmës së garantuar minimale,
  - të jetë pensionist me pension deri më 15.000 denarë, ose
  - të jetë punëtorë i falimentuar.

### 4. MËNYRA E PARAQITJES NË THIRRJEN PUBLIKE

4.1. Për pranimin e ndihmës financiare dhe për të dëshmuar se kushtet për pjesëmarrje në thirrjen publike janë të përmbushura, parashtruesi është i detyruar që të parashtojë dokumentacionet vijuese:

- Kërkesën e plotësuar për ndarjen e ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social të cilët janë të goditur nga kriza energjetike dhe financiare për vitin 2023 (kërkesa do të shpalljet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).
- Deklaratën e verifikuar te noteri se parashtruesi është i pajtuar që të dhënat personale të tij të shfrytëzohen vetëm për këtë qëllim, se parashtruesi është banorë i qytetit të Shkupit, se i përket kategorisë së personave të rrezikuar për nga aspekti social, (deklarata për parashtruesin, do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).
- Vërtetimi se parashtruesi është: person që shfrytëzon ndihmën minimale të garantuar (Vërtetimin e dhënë nga seksionet rajonale të Qendrës mes komunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit).
- Pensionistët me pension në shumën deri më 15.000 denarë (çekun e pensionit të fundit që ka pranuar për muajin qershor / korrik).
- Punëtorët e falimentuar: Vërtetimin nga agjencia për punësime se parashtruesi është punëtor i falimentuar.
- Kopje e faqes së parë – ballinës së llogarisë së transaksionit (personale e parashtruesit, jo e personit të tretë të autorizuar).
- Kopje e letërnjoftimit të parashtruesit.

4.2. Dokumentacionin e nevojshëm, parashtruesit e parashtrojnë deri te Komisioni për ndarjen e ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social për vitin 2023, përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit (baraka 16) në zarf të mbyllur me shenjën: Deri te Sektori për veprimtari publike – Komisioni për ndarjen e ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social, banorë të Qytetit të Shkupit, për ndarjen e ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social të cilët janë të goditur nga kriza energjetike dhe financiare për vitin 2023, çdo ditë pune nga e hëna deri te premten, në periudhën nga ora 09:00 deri në ora 17:00.

4.3. Në raste të dorëzimit të dokumentacioneve të parregullta (që nuk lexohen), Komisioni mban të drejtën që të kërkojë plotësim të dokumentacionit përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit ose të skanuar përmes trajtës elektronike përmes e – mailit:

socijala@skopje.gov.mk, gjë që duhet të realizohet në afatin prej 7 ditëve nga dita e njoftimit. Nëse plotësimi i dokumentacionit nuk realizohet në afatin e paraparë, dokumentacioni i parashtruar si shtojcë e kërkesës do të konsiderohet si i pa plotë dhe i pa kompletuar.

## **5. MËNYRA E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE**

5.1. Për përcaktimin e përmbushjes së kushteve për ndarjen e ndihmës financiare, Kryetari i Qytetit të Shkupit do të formojë Komisionin për ndarjen e ndihmës financiare për personat e rrezikuar për nga aspekti social për vitin 2023 (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni).

5.2. Pagesa e mjeteve do të realizohet në mënyrë sukcesive, sipas radhitjes së kërkesave të dorëzuara, deri në skadimin e buxhetit të paraparë për këtë qëllim.

5.3. Kur do të përfundojnë mjetet e parapara financiare, Qyteti i Shkupit do të shpall përfundimin e thirrjes publike përmes ueb faqes së internetit.

5.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, në propozim të Komisionit miraton Aktvendim për ndarjen e ndihmës financiare për parashtruesit të cilët i kanë përmbushur kushtet në pajtim me pikën 3 të kësaj thirrjeje publike.

5.5. Në rastet kur nuk do të pranohen kërkesat e parashtruara, për shkak të dorëzimit të dokumentacioneve të pa plota dhe të parregullta, ose në rastet kur parashtruesi nuk i përmbush kushtet e pikës 3 të kësaj thirrjeje publike, Komisioni do ta njoftojë parashtruesin për shkaqet e refuzimit të kërkesës.

**QYTETI I SHKUPIT**